

VENDIM
Nr. 229, datë 1.4.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 486, DATË 17.6.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHTYPJEN, BOTIMIN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN
E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 e 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a”, e pikës 6, të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Nxënësit, që ndjekin arsimin bazë, nga klasa e parë deri në klasën e pestë, në institucionet arsimore publike, në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit dhe në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të cilëve u jepen tekstet shkollore të reja, çdo vit, në përdorim falas. Nxënësve, që ndjekin arsimin bazë në këto institucione, nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, u jepen tekstet shkollore në përdorim falas.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama